



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:111138
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05832261

K.DH.SH.II.nr.1136/24

GJYKATA KOMERCIAALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Dren Rugova, dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit N.P.T “B...H...” B.I me pronar G.B. me seli në Pejë, rruga “...”p.n me NUI 810402826, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Murat Paçarada nga Prishtina, kundër të paditurës-kundërpropozuesi, Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të shtyrjes së ekzekutimit të vendimit OSHP nr. 2024/0034 të datës 27.03.2024, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative K.A.nr.185/24 të datës 29.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e paditësit-N.P.T “B...H...” B.I me pronar G.B. me seli në Pejë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative K.A.nr.185/24 të datës 29.04.2024, Vërtetohet.

A r s y e t i m i

1 (6)

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, është vendosur si në vijim;

“REFUZOHET si i pabazuar propozimi i paditësit – propozuesit N.P.T “B...H...” B.I me seli në Pejë me numër indetefikues 810402826, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit me nr. OSHP 2024/0034, të datës 27.03.2024 deri në shqyrtimin e kërkesëpadisë si e pa bazuar.”

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi/propozuesi i masës së sigurisë përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës të Ligjit për Konflike Administrative, për shkak të shkeljes së dispozitave të LPP-së si dhe për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjës faktike, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar, të anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë –Departamenti Për Çështje Administrative, me numër KA.nr.185/24 i datës 29.04.2024 dhe çështja të kthehet në rivendosje.

E paditura nuk ka paraqit përgjigje në ankesë edhe pse ankesën e ka pranuar me datën 28.05.2024.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi-propozuesi N.P.T “B...H...” B.I me pronar G.B. me seli në Pejë, përmes përfaqësuesit të tij sipas autorizimit, pranë Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Çështje Administrative, ka iniciuar konflikt administrativ kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, ndaj vendimit OSHP 2024/0034, të datës 27.03.2024. Paditësi së bashku me padi, ka propozuar - kërkuar edhe shtyrjen

e ekzekutimit të vendimit të OSHP 2024/0034, të datës 27.03.2024 deri në vendimin përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë.

Gjykata e Shkallës së parë ka marrë aktvendimin e ankimuar me arsyetim se, nga propozimi - kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditurës dhe shkresave tjera të lëndës, nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të aprovuar të njëjtën pasi që paditësi pretendimet e paraqitura në propozim nuk i ka mbështetur në prova materiale pra nuk ka propozuar prova më të cilat do të vërtetohej se të njëjtit do ti shkaktohej dëm vështirë i riparueshëm si dhe nuk është argumentuar se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, kushte këto të përcaktuara në nenin 22 par 2 të LKA-së. Ndër të tjera ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar si të pa bazuar edhe pretendimet e paditësit lidhur me dëmin që do ti shkaktohej në rast se nuk shtyhet ekzekutimi i vendimit që kanë të bëjnë me dëmin material që potencialisht ka mundur të i shkaktohet paditësit gjatë fazës së aplikimit në aktivitetin e prokurimit si dhe dëmi për shkak të përgaditjeve që ka bërë paditësi për realizimin e projektit por të njëjtat gjykata e shkallës së parë i ka refuzuar për shkak se shpenzimet financiare për përgaditjen të pjesëmarrjës në procedurë të prokurimit së pari nuk janë shpenzime të garantuara se do të rimbursohen në rast të eliminimit gjatë procedurës së prokurimit dhe se dyti nuk janë të pa kompenzueshme apo vështirë të realizueshme në rast të vërtetimit të kundërligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar. Ndër të tjera ka cek se sa i përket pretendimit se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me intresin publik nga fakti se me asgjë nuk reflekton në ndonjë dëm material apo dëm zhvillimorë, gjykata vlerëson se shtyrja e zbatimit të vendimit të kundërshtuar mund ta pengoj zhvillimin e aktivitetit primar të Autoritetit Kontraktues N.P.K “Trafiku Urban” sh,a me aktivitet për transportin rrugor urban dhe ndër urban të pasagjerëve, prandaj vonesat që do të shkaktoheshin përmes shtyrjes së ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar në aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pjesë rezerv për autobus “Iveco” do ti shkaktonin dëme AK për mirëbatjen dhe riparimin e automjeteve. Krejt në fund ka cek se nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 22par 2 të LKA-së dhe se paditësi nuk e ka bërë të besushëm kërkesën e tij mbi ndonjë bazë reale dhe nuk ka arritur që të argumentoj të njëjtat me prova se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit 03.L-202 për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi, me propozimin e ushtruar, kërkon që të shtyhet ekzekutimi i vendimit OSHP nr. 2024/0034 të datës 27.03.2024, deri në vendosjen meritore të padisë lidhur me këtë lëndë.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të propozuesit-paditësit, në ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të qëndrueshme, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të ankimuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së propozuesit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi-propozuesi, nuk ka bërë të besueshme pretendimet se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit

të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk i ka vlerësuar drejtë të drejtën materiale dhe se nuk i ka konstatuar drejt gjendjen faktike, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1136/22 datë 18.06.2024

Kryetarja e Kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2024:111138
Datë: 18.06.2024
Numri i dokumentit: 05832261